

**AUTORITETI SHTETËROR PËR INFORMACIONIN GJEOHAPËSINOR**

**(ASIG)**

**RAPORTI I PUNËS PËR PERIUdhËN**

**Janar - Dhjetor 2022**



# AUTORITETI SHTETËROR PËR INFORMACIONIN GJEOHAPËSINOR

## RAPORTI I PUNËS PËR PERIUDHËN JANAR - DHJETOR 2022

<b>I. Objektivat e realizuara .....</b>	<b>2</b>
<b>II. Programi i Përgjithshëm Analitik i Projekt-akteve 2022 &amp; 2023 .....</b>	<b>4</b>
<b>III. Plani Kombëtar i Integritimit Evropian (PKIE) 2022 &amp; 2023.....</b>	<b>4</b>
<b>IV. Aktet nënligjore .....</b>	<b>5</b>
<b>V. Investimet 2022 .....</b>	<b>5</b>
<b>VI. Buxheti 2022 dhe 2023 .....</b>	<b>7</b>
• <b>Buxheti 2023 .....</b>	<b>7</b>
<b>VII. Vakancat.....</b>	<b>7</b>
<b>VIII. Problematikat e evidentuara .....</b>	<b>8</b>

# AUTORITETI SHTETËROR PËR INFORMACIONIN GJEOPAPËSINOR

## I. Objektivat e realizuara

Për vitin 2022, ASIG ka identifikuar dhe planifikuar realizimin e objektivave të përgjithshme si më poshtë:

1. Ndërtimi, mirëmbajtja dhe funksionimi i KRGJSH-së si sistem referues gjeodezik i saktësisë së lartë dhe i unifikuar me sistemin evropian, në funksion të realizimit të punimeve gjeodezike dhe hartografike sipas standardeve bashkëkohore.
2. Krijimi i GIS-it Kombëtar dhe funksionimi i Gjeoportalit Kombëtar, për të ofruar informacion gjeohapësinor të përditësuar dhe me standarde në funksion të vendimmarrjeve të drejta për zhvillimin e qëndrueshëm të vendit dhe mbrojtjen e mjedisit.
3. Harmonizimi i të dhënave gjeohapësinore ekzistuese dhe krijimi i të dhënave të reja për temat e gjeoinformacionit, veçanërisht i hartës bazë, në përputhje me standardet e miratuara me Vendim të Këshillit të Ministrave.
4. Sigurimi dhe menaxhimi i burimeve financiare (nga buxheti i shtetit dhe financimet e huaja), menaxhimi i burimeve njerëzore dhe sigurimi i shërbimeve mbështetëse për plotësimin e kërkesave dhe nevojave të institucionit për të garantuar inputet e nevojshme për realizimin e objektivave teknike të tij.

Për përmbushjen e objektivave të mësipërme, për vitin 2022 nga Autoriteti Shtetëror për Informacionin Gjeohapësinor (ASIG), janë realizuar detyrat nga drejtoritë përkatëse si më poshtë:

### Aktivitetet e realizuara

- Përgatitja dhe dërgimi për miratim i projekt-aktit: “ Për organizimin dhe funksionimin e Autoritetit Shtetëror për Informacionin Gjeohapësinor”.
- Në zbatim të kontratës “Për realizimin e “Shërbimit Satelitor për monitorimin me teknologji të avancuar të territorit të Republikës së Shqipërisë””, nga data 5 dhjetor 2022 deri në 22 dhjetor 2022, në ambientet e Autoritetit Shtetëror për Informacionin Gjeohapësinor (ASIG) u zhvillua trajnimi nga operatori ekonomik Satellogic USA Inc. dhe GDI, i personelit teknik që do të përgjigjet për realizimin e këtij shërbimi.
- Pjesëmarrje në grupin negociator për blerjen e teknologjisë UAV. Hartimi i projektit teknik dhe dokumentacionit të nevojshëm për vijimin e procedurave të realizimit të projektit të monitorimit të territorit me teknologji të avancuar. (Imazhet satelitore dhe Drone).
- Monitorimi dhe verifikimi i funksionimit të stacioneve ALBCORS, të rrjetit aktiv të KRGJSH-së (27 stacione), përgatitje e dokumentacionit dhe raporteve periodike.
- Monitorim dhe asistencë për funksionimin e rrjetit të stacioneve mareografike (Sarandë, Orikum, Durrës, Shëngjin), përgatitje e dokumentacionit dhe realizimi i tenderit për blerje

## AUTORITETI SHTETËROR PËR INFORMACIONIN GJEOPAPËSINOR

pajisje për mirëmbajtje dhe hartimi i raporteve periodike. Në bashkëpunim me Komandën e Forcave Detare janë kryer riparime dhe zëvendësimi i pajisjeve të dëmtuara në stacionet mareografike të instaluar në vendbazimet Pashaliman (Orikum) dhe Shëngjin.

- Janë realizuar matjet e pikave të rrejtit të datumit gjeodezik të Republikës së Shqipërisë Rendi i Parë (41 pika).
- Në mbështetje dhe në bashkëpunim me Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit dhe Institutin e Gjeografisë dhe Infrastrukturës Ushtarake, ka përfunduar procesi i matjes së shenjave të kufirit (piramidat) me Greqinë (faza e dytë) për sektorin Tre Urat - Gjiri i Ftelias dhe me përfundimin e kësaj faze janë përfunduar dhe dakordësuar të gjitha koordinatat e shenjave kufitare për gjatë gjithë kufirit tokësor me Greqinë.
- Realizimi i rilevimit 3D (fotogrametrik) për zonat prioritare për zhvillimin ekonomik dhe turistik dhe përpunimi i informacionit hartografik të përfutur. Verifikimi në terren dhe përpunimi i informacionit hartografik për zonat prioritare për zhvillimin ekonomik dhe turistik si: *Krujë, Tiranë (zonat periferike), Cërrik* (në total 60 Km<sup>2</sup>).
- Në kuadër të rritjes së bashkëpunimit me homologët ndërkombëtarë është realizuar me mbështetjen e asistencës Norvegjeze (SK), pjesëmarrja në asamblenë e përgjithshme të EuroGeographics (Sarajevë, 16 - 17 maj 2022); webinar, workshop (online) etj.
- Përgatitja e specifikimeve teknike për realizimin projektit teknik të prodhimit të ortoimazherisë nga fotografimi historik në bashkëpunim me arkivin e Institutit të Gjeografisë dhe Infrastrukturës Ushtarake (IGJIU). Deklasifikimi i materialeve është realizuar në muajin Dhjetor 2022, duke hapur mundësinë për të vijuar procedurat për realizimin e projektit.
- Realizimi i projektit "Përmirësimi i sistemit të Gjeoportalit Kombëtar" dhe përgatitja e dokumentacionit të nevojshëm.
- Publikimi në Gjeoportalin Kombëtar i të dhënave gjeohapësinore sipas standardit të miratuar për hartën bazë topografike, shk. 1:2000 për zonën Tiranë - Durrës - Krujë.
- Asistencë teknike Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit për: "Harta e stacioneve të plazheve", për sezonin 2023.
- Miratuar nga Këshilli i Ministrave i paketës së akteve për "Për miratimin e dokumentit Standardet Shtetërore për Specifikimet Teknike të Informacionit Gjeohapësinor në Shqipëri - temat:
  1. "Infrastruktura bujqësore dhe akuakultura";
  2. "Kushtet atmosferike" dhe "Meteorologjia";
  3. "Hidrologjia".
- Fotografimi me teknologjinë 360 gradë i rrugëve në qytetin e Tiranës.

## AUTORITETI SHTETËROR PËR INFORMACIONIN GJEOHAPËSINOR

### II. Programi i Përgjithshëm Analitik i Projekt-akteve 2022 & 2023

Afati i planifikimit	P/akte të planifikuara	Akte të miratuara	Përqindja e realizimit	Në proces
4M1	2	2	100%	-
4M2	1	1	100%	-
4M3	1	-	%	1
<b>TOTALI PPAP 2022</b>	<b>4</b>	<b>3</b>	<b>75%</b>	<b>-</b>

#### Projekt-aktet për t'u miratuar dhe statusi i tyre:

1 - Projekt-vendim "Për miratimin e dokumentit "Standardet Shtetërore të GIS-it Kombëtar".

Është përgatitur drafti nga ana e ASIG. Duhet të miratohet nga Bordi i Informacionit Gjeohapësinor (BIG) përpara se të përcillet për miratim në Këshillin e Ministrave.

**PPAP 2023:** Është përgatitur drafti i PPAP 2023 dhe i është përcjellë sektorit përkatës në Kryeministri sipas afateve kohore të planifikuara. Në PPAP 2023, miratuar me VKM-në nr. 862 datë 27.12.2022, janë përfshirë 8 projektaktet e planifikuara nga ASIG (7 Standarde tematike të gjeoinformacionit si dhe Standardi i GIS-it Kombëtar)

### III. Plani Kombëtar i Integritimit Evropian (PKIE) 2022 & 2023

Afati i planifikimit	P/akte të planifikuara	Akte të miratuara	Përqindja e realizimit	Në proces
4M1	-	-	%	-
4M2	-	-	%	-
4M3	-	-	%	-
<b>TOTALI PKIE 2022</b>	<b>-</b>	<b>-</b>	<b>%</b>	<b>-</b>

#### Projekt-aktet për t'u miratuar dhe statusi i tyre:

Nuk ka projekt-akte të planifikuara për vitin 2023.

**PKIE 2023:** Nuk kemi parashikuar projekt-akte për PKIE për vitin 2023, (Procesi i përafrimit të legjislacionit lidhur me Direktivën INSPIRE është përmbyllur).

## AUTORITETI SHTETËROR PËR INFORMACIONIN GJEHAPËSINOR

### IV. Aktet nënligjore

Institucioni	Akte nënligjore për miratim	Akte të miratuara	Përqindja e realizimit	Në proces	Cilit ligj i përkasin aktet nënligjore në proces?
ASIG	1	1	100 %	-	-

VKM Nr. 863, datë 27.12.2022, "Për disa shtesa dhe ndryshime në VKM Nr. 147, datë 20.2.2013, Për Miratimin e Rregullores "Për Organizimin dhe Funkcionimin e Autoritetit Shtetëror për Informacionin Gjeohapësinor"

### V. Investimet 2022

Nr.	Autoriteti Kontraktor	Objekti i prokurimit	Buxheti	Shpallur ose jo	Statusi
1	Autoriteti Shtetëror për Informacionin Gjeohapësinor (ASIG)	Ndërtimi i pjesshëm i Komizës Referuese Gjeodezike (Faza III)	73,000,000	Po	Procedura e prokurimit përfundoi pa ofertues. Fondet janë kthyer në buxhetin e shtetit.
2	Autoriteti Shtetëror për Informacionin Gjeohapësinor (ASIG)	Prodhim i ortofotove nga fotografitë historike që ndodhen në arkivin e IGJIU	2,700,000	Jo	Nuk pati kohe të mjaftueshme për zhvillim e procedurës së prokurimit pasi deklasifimi i informacionit nga IGJIU u bë në muajin Tetor 2022. Fondet u kthyen në buxhetin e shtetit.

**AUTORITETI SHTETËROR PËR INFORMACIONIN GJEHAPËSINOR**

<b>3</b>	<b>Autoriteti Shtetëror për Informacionin Gjeohapësinor (ASIG)</b>	Blerje dhe instalim pajisjesh për stacionet mareografike të Shëngjinit dhe Orikumit	1,200,000	Po	Përfunduar
<b>4</b>	<b>Autoriteti Shtetëror për Informacionin Gjeohapësinor (ASIG)</b>	Blerje orendi dhe pajisje për mobilimin e zyrave	100,000	Po	Përfunduar
<b>5</b>	<b>Autoriteti Shtetëror për Informacionin Gjeohapësinor (ASIG)</b>	TVSH për projektin “Për rritjen e kapacitetit të ASIG për të siguruar informacion gjeografik për përdoruesit”, (projekt me qeverinë norvegjeze)	2,950,000	Po	Rimbursimi i TVSH-së si pjesë e kostove lokale për projektin: “Rritja e kapaciteteve të ASIG”, të financuar nga qeveria norvegjeze është me pagesë direkte.
<b>6</b>	<b>Autoriteti Shtetëror për Informacionin Gjeohapësinor (ASIG)</b>	Blerje pajisje elektronike (HDD i jashtëm 8 TB)	50,000	Po	Përfunduar me sukses. Për shkak të vlerës nën 100,000 lekë procedura nuk u zhvillua në sistemin elektronik të APP por u zhvillua blerje direkte.

## AUTORITETI SHETETËROR PËR INFORMACIONIN GJEHAPËSINOR

### VI. Buxheti 2022 dhe 2023

Investimet	Planifikim	Obligim	Realizim	% e realizimit
<b>Financim i Brendshëm</b>	165,795,000	0	53,373,637	32.1%
<b>Financim i Huaj</b>	0	0	0	0%
<b>Total</b>	165,795,000	0	53,373,637	32.1%

	Plan Buxheti	Buxheti Faktik	% realizimit
<b>Shpenzime kapitale</b>	80,000,000	1,479,693	1.8%
<b>Shpenzime korente</b>	85,795,000	51,883,944	60.4%
<b>Totali</b>	165,795,000	53,373,637	32.1%

*Komente: Informacioni si më lart përfshin periudhën Janar - Dhjetor 2022.*

*Fondet për shpenzimet kapitale të përdorura janë kthyer në buxhetin e shtetit si fond i lirë.*

*Buxheti i planifikuar në raportim është marrë buxheti fillestar i miratuar pa pakësimet gjatë vitit por vetëm shtesa në llogarinë 606 prej 470,000 lekë.*

#### • Buxheti 2023

	2022	2023	% ndrysh.
<b>Paga (600-601)</b>	57,725,000	59,150,000	2.4%
<b>Korrente të Tjera + Projekte (602-606)</b>	27,600,000	27,600,000	0%
<b>Investime të Brendshme (230-232)</b>	80,000,000	55,000,000	31.2%
<b>Kapitale te Huaja (230-232)</b>	0	0	0%
<b>Totali</b>	165,325,000	141,750,000	14.2%

*Komente:*

### VII. Vakancat

**Numri total i punonjësve të institucionit:** Referuar strukturës së miratuar numri i punonjësve të ASIG është 46 punonjës. Aktualisht janë të punësuar 39 punonjës dhe 7 pozicione janë vakante, përkatësisht si më poshtë:



## AUTORITETI SHTETËROR PËR INFORMACIONIN GJEHAPËSINOR

1. Përgjegjës i Sektorit të Infrastrukturës së Sistemeve CORS, në Drejtorinë e Gjeodezisë dhe Hartografisë;
2. Specialist në Sektorin e Infrastrukturës së Sistemeve CORS, në Drejtorinë e Gjeodezisë dhe Hartografisë;
3. Specialist në Sektorin e Hartografisë, në Drejtorinë e Gjeodezisë dhe Hartografisë;
4. Specialist në Sektorin e Kornizës Referuese Gjeodezike, në Drejtorinë e Gjeodezisë dhe Hartografisë;
5. Specialist në Sektorin e GIS-it Kombëtar, në Drejtorinë e GIS-it Kombëtar dhe Gjeoportalit;
6. Specialist në Sektorin e GIS-it Kombëtar, në Drejtorinë e GIS-it Kombëtar dhe Gjeoportalit;
7. Specialist në Sektorin e Financës, në Drejtorinë e Financës dhe Shërbimeve Mbështetëse.

### **VIII. Problematikat e evidentuara dhe masat që propozojmë**

- Në lidhje me nevojën e paraqitur për shtim të strukturës së ASIG, del e domosdoshme shtimi i hapësirës fizike për zyra për stafin e ASIG.
  - *Për zgjidhjen e sa më sipër, kemi kërkuar mbështetjen e AKSHI-t, për ndërhyrje në hapësirën ekzistuese me qëllim përfitimin e një hapësire për stafin e ri.*
- Plotësimi me staf të ri, për strukturën e re të “Monitorimit të territorit me teknologji të avancuar”.
- Mosfunksionimi i Bordit të Informacionit Gjeohapësinor (BIG).
  - *Duhet të riorganizohet me qëllim funksionimin me kapacitet të plotë*
- Përdorimi i gjerë i “produkteve” të ASIG.
  - *Do të përgatitet një plan komunikimi dhe ndërgjegjësimi për vitin 2023 e në vazhdim, për të publikuar të gjitha këto “produkte” sipas grupeve të interesit me qëllim marketimin dhe rritjen e përdorimit të tyre.*